



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Shëndetësinë, Punën dhe Çështjet Sociale*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 9.2.2021, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Enver Roshi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor” të ndryshuar””.

**Marrin pjesë:**

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Roland Xhelilaj, Adriana Jaku, Florenc Spaho, Almira Xhambulla, Klotilda Bushka, Majlinda Halilaj, Halil Jakimi, Koçi Tahiri, Eugen Bojaxhiu, Amra Barova, Edmond Stojku dhe Ervis Meço.

**Të ftuar:**

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Merita Xhafaj - Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë

dhe Mbrojtjes Sociale

## HAPET MBLEDHJA

**Enver Roshi** – Të nderuar deputetë fillojmë mbledhjen e Komisionit të Shëndetësisë, Punës dhe Çështjeve Sociale.

Në lidhje me shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor” të ndryshuar” sot kemi diskutimin në parim. Kjo është nismë e Këshillit të Ministrave dhe komisioni e shqyrton në cilësinë e komisionit përgjegjës. Relatore për këtë është Edlira Bode.

Marrin pjesë nga Ministria e Shëndetësisë zonja Mira Rakacolli, zëvendësministre, Antoneta Njehrrëna, drejtoreshë Juridike, zonja Merita Xhafaj, drejtoreshë e Përgjithshme.

Ftoj Ministrinë e Shëndetësisë të na flasë shkurtimisht në parim në lidhje me këtë projektligj të paraqitur në Kuvend për ndryshime.

Fjala për ju, zonja Zëvendësministre.

**Mira Rakacolli** – Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sjell përpara këtij komisioni për të miratuar dhe diskutuar këtë projektakt “Për disa ndryshime në ligjin nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor””, ndryshime, të cilat konsistojnë në një përmirësim akoma më të mirë të mënyrës së trajtimit të pacientëve që vuajnë nga problemet e shëndetit mendor. Këto ndryshime janë vlerësuar dhe janë propozuar në bazë të rekomandimeve që Komiteti për Parandalimin e Torturës ka dhënë si rezultat i vlerësimit mbi bazën e një vizite që ka kryer në shërbimet tona të shëndetit mendor dhe nën vlerësimin e akteve tona legjislative, që rregullojnë problemet e shëndetit mendor në fund të vitit 2018.

Me pak fjalë, ku konsistojnë këto ndryshime që janë tashmë të propozuara? Në ligjin aktual nuk është i ndarë koncepti i shtrimit nga koncepti i trajtimit, qoftë ky i vullnetshëm, apo i pavullnetshëm. Ndërsa rekomandimi i Komitetit ka qenë që të diferencohet koncepti i trajtimit nga koncepti i shtrimit dhe kjo është reflektuar në projektaktin për të cilin ne propozojmë ndryshimet. Pra, në këtë projektakt është ndarë koncepti i trajtimit të të sëmurëve të shëndetit mendor nga ai i shtrimit të të sëmurëve që kanë probleme të shëndetit mendor, qoftë ky i vullnetshëm apo i

pavullnetshëm. Më tepër jemi ndalur në ndryshimet që kanë të bëjmë me shtrimin e pavullnetshëm. Në të dyja rastet kërkohet konsensusi i pacientit, ose kur shtrimi është i vullnetshëm i një konsensusi të informuar, pra pasi pacienti informohet për gjendjen e tij dhe argumentohet arsyeja e trajtimit. Sot ai duhet të firmosë këtë konsensus pasi i është shpjeguar nga mjeku dhe nga një kujdestar ligjor, kur ai nuk ka zotësinë e vet për të vepruar. Pra propozohet që kur bëhet fjalë për shtrimin e një personi, i cili nuk ka aftësi ligjore për të vepruar, vlerësimi i tij të bëhet edhe nga një person tjetër, i cili është jashtë institucioneve, pra përveç mjekut dhe shefit të shërbimit, që bën rekomandimin për trajtimin e tij si i shtruar në qendrat, që trajtojnë pacientët, të cilët vuajnë nga problemet e shëndetit mendor, të merret edhe një mendim nga një person, i cili nuk është pjesë e institucionit, kur mendohet që ky shtrim bëhet në kundërshtim me vullnetin e personit, i cili nuk ka aftësinë për t'u përgjigjur për problemet e tij. Ky është një koncept bashkëkohor, që shkon në përputhje me të gjitha trajtimet që bëhen kudo në vendet e Europës Perëndimore dhe në vende të tjera të botës të përparuara, që merren me të drejtat e personave, të cilët vuajnë nga problemet e shëndetit mendor.

Në ligjin e tanishëm, nëse kujdestari ligjor i një personi, i cili konsiderohet i paaftë për të marrë vendime për shëndetin e tij, me vendim gjykatë ai shtrohet, ndërsa në projektaktin që ne sjellim për diskutim dhe miratim futet edhe një koncept tjetër: kur personi, pavarësisht se ka një kujdestar ligjor për t'u përgjigjur për veprimtarinë e tij, nuk është dakord për shtrimin, menjëherë t'i kalojë gjykatës. Gjykata ta rivlerësojë dhe t'ia japë edhe një herë mundësinë që kur personi nuk është dakord, të shprehë pretendimet e veta dhe nëse rivlerësohet të ndjekë përsëri rrugën që i është propozuar.

Nga ana tjetër, ndryshimi që parashikon ky projektakt është edhe fakti që nëse merret një vendim, që personi të trajtohet si i shtruar në institucionet, që bëjnë kujdesin për pacientet e shëndetit mendor, të mos jetë një vendim, i cili është pa fund deri në momentin që mjeku gjykon që ai nuk ka më nevojë të jetë i pranishëm, por të rivlerësohet çdo 28 ditë. Çdo 28 ditë gjykata rivlerëson nëse mbetet në fuqi ai vendim, që është marrë për ta shtruar këtë pacient në kundërshtim me vullnetin e tij, pavarësisht se ai ka një kujdestar ligjor për të marrë ato vendime të rëndësishme që kanë të bëjnë me jetën e tij.

Diçka tjetër që parashikojnë ndryshimet e këtij ligji është futja në ligj e konceptit të pjesëmarrjes së ndihmësit, që ka personi që vuan nga problemet e shëndetit mendor. Pra kur bëhet fjalë për të qenë pjesë e jetës së komunitetit në këtë jetë do të marrë pjesë edhe ai person, i cili

është caktuar si ndihmës i këtij personi, sipas akteve, që rregullohen në ligje të tjera. Natyrisht që në projektligj parashikohen edhe penalitete për ata persona, të cilët nuk i respektojnë ato dhe që janë kryesisht mjeku, apo shefi i shërbimit, i cili merr vendime jo në përputhje, nuk i jep informimin e duhur pacientit dhe nuk e bën atë të nënshkruajë i vetëdijshëm konsentin e informuar. Pra, parashikon edhe penalitete për të gjithë ata që nuk i zbatojnë këto vendime.

Një risi që mendohet se sjell ky projektakt në ndryshimet që propozojmë për ligjin e shëndetit mendor është ajo e tjetërsimit ose e ngritjes cilësore të asaj që sot është qendra për zhvillimin dhe terapinë e fëmijëve dhe adoleshentëve, që, ndërsa sot merret vetëm me probleme që kanë të bëjnë me fëmijët deri në moshën 6 vjeç, të shtrihet dhe të jetë dhe për fëmijët, dhe për adoleshentët, pra deri në moshën 18 vjeç, në mënyrë që t'i sigurohet kësaj pjese shumë të rëndësishme të popullsisë një kujdes më i madh dhe më i integruar, për të bërë të mundur të realizohet si duhet qëllimi i kësaj qendre, që, duke u marrë që në vogëli me problemet e fëmijëve dhe të rinjve, ata të integrohen sa më mirë të jetë e mundur në zhvillimet e shoqërisë.

Pra, me pak fjalë, këto janë momentet kyçe dhe ndryshimet që propozohen në projektaktin që ministria jonë ka sjellë për diskutim pranë këtij komiteti të nderuar dhe unë jam e hapur për çfarëdolloj pyetje ose paqartësie që mund të kenë të nderuarit deputetë, nëse unë nuk arrita t'i sqaroj ata siç duhet gjatë këtij prezantimi.

Ju faleminderit!

**Enver Roshi** – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Unë desha të ftoj relatore, Edlirën, për të folur shkurt dhe në mënyrë koncize, pasi ky projektligj do të kalojë për diskutim nen për nen pasnesër, ditën e enjte, dhe do të shqyrtohet pak më hollësisht, ndoshta për të mos përsëritur gjëra edhe të enjten.

**Edlira Bode** – Përshëndetje të gjithëve!

Kryetar, faleminderit për fjalën!

Falënderoj zonjën zëvendësministre për parashtrimin që i bëri projektligjit! Më lejoni ta falënderoj dhe për të gjithë punën që ajo personalisht, por edhe e gjithë Ministria e Shëndetësisë janë duke bërë në këtë periudhë tashmë të zgjatur e me mbingarkesë për shkak të pandemisë!

Për projektligjin për të cilin po flasim sot do të them vetëm dy fjalë shkurtimisht. E kam parë me vëmendjen projektligjin. Për të gjithë kolegët dhe të gjithë publikun, ne kemi një ligj të vitit 2012 për shëndetin mendor, që ka vendosur themelet, ka rregulluar procedurat dhe ka krijuar kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor, duke siguruar kujdes shëndetësor, sikurse ka siguruar

mjedis social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe, gjithashtu, ka sanksionuar politika parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Gjatë këtyre viteve ky ligj ka prodhuar efektet e tij pozitive, por në vazhdim është parë që ka pasur mangësi për aspekte të veçanta, për të cilat zonja zëvendësministre na foli shumë mirë dhe që synon t'i përmbushë ky projektligj, që kanë të bëjnë me një dallim të qartë, për shembull, midis shtrimit dhe trajtimit, që në ligjin aktual nuk është e qartë; që kanë të bëjnë me të drejtën e një personi të cilit nuk i është hequr zotësia për të vepruar dhe është subjekt i procedurave të shtrimit apo trajtimit të pavullnetshëm, pra që të ketë dhe ai të drejtën t'i drejtohet gjykatës për rishikim të vendimit.

Ky ligj i kërkon gjykatës të marrë opinionin e një psikiatri jashtë shërbimit të shëndetit mendor, kur bëhet fjalë për të rivlerësuar vendimin për trajtim të pavullnetshëm apo shtrim të pavullnetshëm.

Tani sanksionohet me ligj, sepse në ligjin aktual mungon parashikimi për shqyrtimin periodik të vendimeve të gjykatës, pra të gjitha ato që i parashtroi zonja zëvendësministre.

Këto dhe të tjerat do t'i shikojmë me hollësi e saktësi edhe gjatë shqyrtimit nen për nen. Të gjitha janë në përputhje me konstatimet dhe rekomandimet e Komitetit European për Parandalimin e Torturës, të Këshillit të Europës.

Pra, në tërësi qëllimi, që realizohet më së miri me ndryshimet i këtij projektligji, është mbrojtja dhe promovimi i shëndetit mendor; parandalimi i problemeve që lidhen me të; garantimi i të drejtave dhe përmirësimi i cilësisë së jetës të personave me çrregullime të shëndetit mendor.

Duke qenë të gjithë dakord që shëndeti mendor është pjesë integrale e shëndetit dhe e mirëqenies së përgjithshme të popullatës, unë i ftoj kolegët që sot ta miratojmë në parim këtë projektligj, natyrisht, duke i lënë gjërat e vogla, për të cilat dhe mund të diskutojmë, për herën tjetër, kur ta shqyrtojmë projektligjin nen për nen.

Faleminderit!

**Enver Roshi** – Faleminderit, Edlira!

Unë desha t'u thosha deputetëve që sot është dhe një takim i parlamentit me Akademinë e Shkencave, pra një konferencë në të cilën jeni të ftuar edhe ju, edhe unë. Ndaj do t'ju lutesha që një pjesë të pyetjeve t'i bënit ditën e enjte, për ta parë dhe më mirë ligjin, por ndoshta dhe për t'i kushtuar dhe më shumë kohë kalimit nen për nen të projektligjit. Ju ftoj ta kalojmë në parim sot këtë projektligj.

Nuk e di nëse e kam miratimin tuaj për ta kaluar në parim apo ka ndonjë pyetje ose koment të shkurtër, për të mos u zgjatur. Nëse nuk ka pyetje ose komente, ju ftoj ta votojmë në parim projektligjin.

Kush është dakord me miratimin në parim të këtij projektligji? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji dhe kalon për shqyrtim ditën e enjte, në orën 10:00. Gjithsesi, orari do t'ju njoftohet sërish në një moment tjetër, sot ose nesër.

Shihemi ditën e enjte, në mbledhjen e radhës së Komisionit të Shëndetësisë, Punës dhe Çështjeve Sociale!

Ditë të mbarë!

Ju ftoj të merrni pjesë në takimin midis Akademisë së Shkencave dhe parlamentit, për parlamentarizmin dhe përballimin e pandemisë COVID-19.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**